



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E ISTOGUT**  
**Drejtoria për Arsim dhe Kulturë**  
**05.Nr. 9 / 13**  
**Datë: 10.01.2013**



Në mbështetje të Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 5 , pika c dhe d , në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, neni 20 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it (Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore e aftësuese) nr.3/2009 dt.9.02.2009, neni 2 pika 2, Rregulloren Komunale për Punën e Institucioneve Arsimore nr.6/2012, neni 12, Drejtori Komunal i Arsimit në Istog, shpall:

**Konkurs**

- Drejtor në shkollën “Ismail Qemali” Saradran
- Drejtor në shkollën “Avni Rustemi” Zallq
- Drejtor në gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog
- Drejtor në SHMT “Mithat Frashëri” Gurrakoc

Detyrat e punës:

- Drejtori i shkollës ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit edukativ-arsimor.
- Menaxhon dhe është përgjegjës për punën e gjithëmbarshme të shkollës në harmoni me dispozitat ligjore,statutin dhe rregulloret komunale.
- Është përgjegjës për zhvillimin e procesit arsimor sipas plan-programeve mësimore që ka miratuar MASHT,
- Menaxhon dhe është përgjegjës për pasurinë dhe mjetet financiare të shkollës në bashkëpunim me DKA-an,
- Krijon kushte materiale, teknike dhe profesionale për zhvillimin normal të procesit edukativo-arsimor,
- Koordinon punën me të gjitha organet profesionale dhe drejtuese të shkollës,
- Kryen edhe punë tjera nga fushëveprimi dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj.

Kushtet e konkursit:

- a) Të kenë të kryer njërën nga fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës ose fakultetet private të akredituara dhe të licencuara nga MASHT. Të dëshirueshme janë edhe kualifikimet shtesë për emërim në pozitë udhëheqëse të institucionit arsimor sipas nenit 34, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës.
- b) Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- c) Të kenë së paku tri vite përvojë pune në arsim,

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Certifikatën e lindjes ,
- Kopje e letërnjoftimit,
- Diplomën e fakultetit të kryer,
- Dëshminë për përvojën e punës,

- CV-në sipas modelit të MASHT-it,
- Dy rekomandime nga persona civil apo institucione,
- Programin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (më se shumti 5 faqe tekst, me 30 rreshta në letër të formatit A-4),
- Certifikatat e trajnimeve të kryera,
- Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja e shëndetësore.

Afati i konkurrimit 15 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentacioni i pa kompletuar dhe i arritur pas afatit nuk shqyrtohet.

Formularët për aplikim merren në Zyrën e Drejtorisë Komunale të Arsimit nr.23, ndërtesa e Komunës, kati i dytë.

Drejtori i DKA-së

Agim Haxhiu \_\_\_\_\_